



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201501627/15

Tiranë ____/____/2018

Lënda: *Rekomandohet shqyrtimi në mbledhjen e radhës së Këshillit të Qarkut Durrës të kërkesës për varrimin e Dëshmorit të Atdheut N.K. në Varrezat e Dëshmorëve në Durrës si dhe paraqitja në Ministrinë e Punëve të Brendshme të planit financiarë për këtë rast*

Drejtuar: **Kryetarit të Bashkisë Durrës**
Z. Vangjush DAKO

Krytarit të Bashkisë Shijak
Z. Ardian KOKOMANI

Kryetarit të Bashkisë Krujë
Z. Artur BUSHI

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi I. K., i cili pretendon se i është drejtuar disa herë institucioneve të pushtetit vendor për të vendosur trupin e djalit N. K. në Varrezat e Dëshmorëve pranë Mauzoleumit të Durrësit, por kërkesa e tij nuk ka marrë zgjidhje. Djali i ankuesit ka humbur jetën gjatë detyrës si punonjës i policisë së shtetit dhe është shpallur Dëshmor i Atdheut me Vendimin Nr.405, datë 25.04.2011 të Komisionit Qëndror të Statusit "Dëshmor i Atdheut".

Referuar legjislacionit në fuqi, varrimi i dëshmorit të atdheut në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në qarqe bëhet me vendim të Këshillit të Qarkut ose Prefektit. Këshilli i Qarkut i paraqet Ministrisë së Punëve të Brendshme planin financiarë për shpenzimet e varrimit (pika 3 dhe 4 e VKM Nr.151, dt. 25.04.2001). Për këtë arsye i jemi drejtuar fillimisht Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës për të na informuar nëse ishte marrë në shqyrtim kërkesa e shtetasit I. K. Në përgjigjen që kemi marrë nga Z. Alfred Mullaraj, ndër të tjera, jemi vënë në dijeni se, kërkesa e shtetasit I. K. nuk ishte plotësuar pasi Këshilli i Qarkut Durrës ndodhej në procesin e konstituimit të tij dhe për rrjedhojë nuk mund të merrej vendimi për varrimin e djalit të ankuesit në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut Durrës. Pas kësaj përgjigjeje i jemi drejtuar disa herë me shkresë Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës për të na informuar nëse kishte përfunduar procesi i konstituimit dhe nëse i kishte paraqitur Ministrisë së Punëve të Brendshme planin financiar për varrimin e Dëshmorit të Atdheut N. K. por, nuk kemi marrë përgjigje. Në mungesë të një përgjigjeje, nëse kishte përfunduar procesi i konstituimit të Këshillit të Qarkut Durrës, i jemi drejtuar për informacion Kryetarit të Bashkisë Durrës, i cili sipas Ligjit "Për vetqeverisjen vendore" ka rol në këtë proces. Në përgjigjen e marrë nga Bashkia Durrës jemi sqaruar se, Këshilli i Qarkut Durrës, në mbledhjen e tij konstituuese të datës 15.10.2015, ka

vendosur zgjedhjen e kryetarit. Ky vendim është gjetur i bazuar në ligj nga Prefekti i Qarkut Durrës Z. Rolant Xhelilaj.

Pasi u informuam për faktin e konstituimit të Këshillit të Qarkut Durrës, me shkresën e datës 24.11.2017, i rekomanduam Z. Mullaraj paraqitjen në Ministrinë e Punëve të Brendshme të planit financiarë për varrimin e Dëshmorit të Atdheut N. K. në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut Durrës. Deri më sot nuk kemi përgjigje lidhur me këtë rekomandim.

Sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” (nenet 72, 76 dhe 77), këshilli i qarkut përbëhet nga përfaqësues të bashkive që bëjnë pjesë në qark dhe kryetarët e bashkive janë kurdoherë anëtarë të tij. Këshilli i qarkut mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj ose edhe jashtë radhës me kërkesë të kryetarit, kryesisë ose një të tretës së anëtarëve. Mbledhja zhvillohet sipas programit të punës që bën këshilli i qarkut, që ndër të tjera, organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm dhe miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë.

Në mungesë të bashkëpunimit nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, është e nevojshme ndërhyrja Juaj dhe e përfaqësuesve të bashkisë të caktuar si anëtarë të Këshillit të Qarkut Durrës që, ky Këshill të realizojë detyrimin ligjor për rastin në fjalë.

Bashkëlidhur rekomandimit do të gjeni fotokopje të: përgjigjes së firmosur nga Z. Mullaraj lidhur me moskonstituimin e Këshillit të Qarkut Durrës; të Vendimit nr.13, datë 15.10.2015 ku thuhet se në këtë datë është konstituuar Këshilli i Qarkut Durrës dhe është zgjedhur kryetari i tij; të shkresës Nr.1656/1 Prot., datë 23.10.2015 të Prefektit të Qarkut Durrës ku verifikohet ligjshmëria e zgjedhjes së Kryetarit të KQDurrës; të shkresës Nr.I-50/1 Prot., datë 10.09.2015 të Ministrisë së Punëve të Brendshme ku i përcillet për kompetencë ky rast Bashkisë Durrës; të shkresës Nr.7114/1 Prot., datë 29.09.2015 të Bashkisë Durrës ku i përcillet për kompetencë ky rast Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës dhe Prefektit të Qarkut Durrës.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Shqyrtimin në mbledhjen e radhës së Këshillit të Qarkut Durrës të kërkesës për varrimin e Dëshmorit të Atdheut N. K. në Varrezat e Dëshmorëve në Durrës dhe paraqitjen në Ministrinë e Punëve të Brendshme të planit financiarë për këtë rast.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditë për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI